

KONTRATË DHURIMI AKSIONESH

Sot më datë 13/09/2019, lidhet kjo kontratë dhurimi aksionesh (“**Kontrata**”) ndërmjet palëve të mëposhtme (veçmas referuar si “**Pala**” dhe në numrin shumësi si “**Palët**”):

DHURUESI: **Z. Amarildo Hasrama**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 11.06.1990, me numër identifikimi personal (NID) J00611092A, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim referuar si “**Dhuruesi**”);

PRANUESI
DHURIMIT: **Z. Bekim Halilaj**, shtetas shqiptar, lindur në Këlcyrë, më datë 20.10.1955, i identifikuar me letërnjoftimin nr. 033276356, nr. personal F51020075R, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim referuar si “**Pranuesi i Dhurimit**”).

MEQENËSE

- A) Dhuruesi është aksionar me të drejta të plota në shoqërinë ENERGI COMPANY Sh.a. (në vijim referuar si “**Shoqëria**”), NUIS L91405045M, me seli në Rruga Don Bosko, perballe Kishes Katolike, pallati Aurora, kati I, Tiranë, dhe zotërues i një pjesëmarrjeje prej 60% të kapitalit të Shoqërisë, e përbërë nga 220 aksione të zakonshme (në vijim referuar si “**Aksionet**”), me vlerë nominale prej 10.000 Lekë secili, të cilët nuk janë të rënduar me barrë apo kufizime të tjera në favor të të tretëve;
- B) Dhuruesi dëshiron t’i dhurojë të gjitha Aksionet e tij, pa asnjë kusht apo barrë, Pranuesit të Dhurimit, i cili pranon;

Në këto kushte, Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 – Objekti

- 1.1 Objekt i kësaj Kontrate është dhurimi pa asnjë kusht dhe kalimi në favor të Pranuesit të Dhurimit të 220 Aksioneve të Dhuruesit në Shoqëri, me vlerë nominale prej 10.000 Lekë secili dhe vlerë nominale totale prej 2.200.000 Lekë, që përbëjnë 60% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 2 - Dhurimi

- 2.1 Palët bien dakord se me nënshkrimin e kësaj kontrate nga Palët, Pranuesi i Dhurimit bëhet pronar dhe zotërues me të drejta të plota i Aksioneve të dhuruara, sipas përcaktimit të nenit 1 më sipër, dhe Dhuruesi zhvishet nga çdo e drejtë e detyrim në lidhje me aksionet e dhuruara.

Neni 3 - Të ndryshme

- 3.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi e prodhon efekte të plota me nënshkrimin e saj nga Palët, dhe përbën të gjithë marrëveshjen mes Palëve lidhur me objektin e saj.

- 3.2 Palët bien dakord qe kjo kontratë dhurimi do te zbatohet dhe interpretohet ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë kontratë dhurimi do të zbatohen parashikimet e Kodit Civil te Republikës së Shqipërisë mbi dhurimin.
- 3.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane do të jetë kompetente për te zgjidhur mosmarrëveshjet qe Palët nuk mund t'i zgjidhin me mirëkuptim ndërmjet tyre.
- 3.4 Kjo Kontratë dhe kalimi i Aksioneve nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) nga secila prej palëve.

Kjo Kontrate Dhurimi hartohet dhe nënshkruhet në 2 (dy) faqe dhe në 3 (tre) ekzemplarë të njëjtë ne gjuhen shqipe.

DHURUESI

Z. Amarildo Hasrama

Amarildo Hasrama



PRANUESI I DHURIMIT

Z. Bekim Halilaj

Bekim Halilaj

